



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 204 / Prot.
16

Tiranë, më 30/06/2023

VENDIM

Nr. 80, datë 30.06.2023

PËR

DISA SHTESA E NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË” TË MIRATUAR ME VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 33, DATË 17.03.2020, I NDRYSHUAR

Në bazë të nenit 3, 38, 61 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” i ndryshuar, të nenit 5, 26, 75 e vijues të Statutit të UMT-së, Senati Akademik pas propozimit të Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, shprehur me Vendimin e tij nr. 11, datë 29.06.2023 “Për propozimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren e fitimit të titujve akademikë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, pasi shqyrtoi propozimin dhe diskutoi në mbledhjen e datës 30.06.2023,

VENDOSI:

1. Në Rregulloren “Për fitimin e titujve Akademikë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” të miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 33, datë 17.03.2020 i ndryshuar, neni 4, pika 4, germa b) ndryshohet si më poshtë:
 - b) anëtarët e personelit akademik të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në rastet kur këto institucione nuk përmbushin kriteret për promovimin akademik. Aplikantët duhet të paraqesin kërkesë me shkrim nga titullari i IAL-së ku ushtrojnë aktivitetin/veprimtarinë akademike, kërkimore e shkencore, që vërteton pamundësinë e dhënies së titullit akademik nga kjo IAL.
2. Në Rregulloren “Për fitimin e titujve Akademikë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” të miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 33, datë 17.03.2020 i ndryshuar, neni 19, pika 2, ndryshohet si më poshtë:

2. Kandidatët e kategorive të pikave b dhe c, të pikës 4, neni 4, paraqesin kërkesën dhe dosjen pranë KPPPA-së. Kur kandidati është personel akademik me kohë të plotë në një IAL tjetër që nuk përmbush kriterin e dhënies së titujve akademik, ai duhet ta shoqërojë kërkesën bashkë me kërkesën e lëshuar nga titullari i IAL-së përkatëse që vërteton pamundësinë e dhënies së titullit akademik nga ajo IAL. KPPPA-ja vendos se cila është njësia kryesore më e përshtatshme për promovimin e kandidatit dhe ia përcjell dosjen kësaj të fundit për fillim të procedurës. Njësia kryesore bën gjithashtu vlerësimin e njësisë bazë më të përshtatshme për vlerësimin e kandidatit dhe ia përcjell dosjen kësaj njësie bazë për vlerësim sipas pikës 1 të këtij neni.
3. Në Rregulloren “Për fitimin e titujve Akademikë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” të miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 33, datë 17.03.2020 i ndryshuar, në nenin 4, shtohet pika 5 me përmbajtje si më poshtë:
 5. Aplikantët për fitimin e titujve akademik “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar” duhet të kenë formim universitar në një nga programet e studimit që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ose të jenë personel akademik me kohë të plotë në UMT, pavarësisht programit të studimit që kanë përfunduar.
4. Ngarkohet për zbatimin e kësaj Rregulloreje Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik dhe njësitë kryesore të UMT-së.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETARI

ARBEN GJATA

